



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:260047

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505436

PPP. nr. 71/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Rr.Sh, nga Gjilani, kundër debitorit A.Rr me vendbanim në Gllogoc, lidhur me borxhin në shumën prej 4,200.00 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat K.M nën shenjën P.nr... i datës 16.11.2022, me datën 25.03.2024 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit A.Rr nga Gllogoci, kundër urdhërit të Përmbaruesit Privat K.M nën shenjën P.nr... i datës 16.11.2022, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit Rr.Sh, me vendbanim në Gjilan, për përmbarimin e borxhit në shumën prej 4,200.00 € me kamatëvonesë vjetore prej 8% nga data 24.04.2019 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 459 € në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan me shenjën C.nr.526/2017 të datës 24.04.2019 të plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, ndërsa Urdhëri i Përmbaruesit Privat nën shenjën P. nr... i datës 16.11.2022 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Kreditori me datën 16.11.2022 ka parashtruar tek përmbaruesi privat K.M Propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të Dokumentit të përmbarueshëm-Aktgjykimit C.nr.526/17 të datës 24.04.2019, lidhur me pagesën e borxhit kryesor në lartësi prej 4,200.00 €, me kamatë vjetore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 459.00 Euro dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sequestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Dokumentit të Përmbarueshëm-të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan me shenjën C.nr.526/2017 të datës 24.04.2019 i plotëfuqishëm me datën 23.09.2022 dhe i ekzekutueshëm me datën 03.11.2022.

Debitori ka paraqitur prapësim kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afatin ligjor me arsyetimin se i njëjti asnjëherë nuk është njoftuar personalisht në lidhje me procedurën gjyqësore që është zhvilluar kundër tij në Gjykatën Themelore në Gjilan, ndërsa sa i përket rastit ka theksuar se në Kompaninë “V...” është vetëm punëtor e nuk është pronar i kësaj kompanie, po ashtu sa i përket pretendimit të kreditorit për borxhin në fjalë ka theksuar se nuk ka asnjë të dhënë e asnjë kompetencë se a është kryer apo jo pagesa e këtij borxhi sepse në këtë kompani është vetëm punëtor

i ekskavatorit e jo edhe financiar në lidhje me pagesat e faturave të kompanisë, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin në tërësi dhe të liroj gjithashtu nga shpenzimet e procedurës.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim duke kundërshtuar prapësimin e debitorit në tërësi si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me asnjë provë, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri P. nr... i datës 16.11.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pa i bazuar, ndërsa kundërshtimet e prapësimit të dhëna nga kreditori në përgjigje në prapësim, gjykata i konsideroi si të qëndrueshme dhe atë për këto arsye si në vijim.

Me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbardim e ka bërë për përmbardimin e dokumentit të pambarueshëm-Aktgjykimit C.nr.526/17 të datës 24.04.2019 i ekzekutueshëm me datën 03.11.2022 të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e përmbarduesit privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbardimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga aktgjykimi i lartëcekur si në rastin konkret.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbardimi, se çka përmbard dokumenti i përmbardimit, se çka duhet të përmbard një propozim për përmbardim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbardimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit 21, 22, 23, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument përmbardues - vendim gjyqësor nga i cili shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj kreditorit pasi që nuk ka bazë ligjore për të kërkuar përmbardim pasi që i njëjti ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj kreditorit me faktin se nuk ka qenë personi kompetent për të kryer pagesat, gjykata këtë nuk e aprovoj pasi që dokumenti përmbardues-Aktgjykimi i cekur më lartë është dokument përmbardues në pajtim me Ligjin e Procedurës Përmbardimore ndërsa kreditori në anën tjetër propozimit për përmbardim i ka bashkangjitur Aktgjykimin C.nr.529/17 i cili i plotëson kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i përmbardueshëm në kuptim të Nenit 22 par. 1 pika 1.1. ku parashihet se “*Dokumente përmbarduese janë: vendimi përmbardues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarduese*”, ndërsa Neni 23 par. 1 i LPP-së parasheh “*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit,.....*”.

Andaj, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhërin përmbardues për caktimin e përmbardimit me numër P.nr... të datës 16.11.2022, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 71/22, datë 25.03.2024**

**G j y q t a r i
Astrit Gashi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.